

Raporti monitorues i keqinformimit për muajin qershor

2023

korrik 2023

Action for
Democratic Society
hibrid.info



Raporti monitorues i keqinformimit për muajin qershor

Publikues: ADS/hibrid.info

Prishtinë, korrik 2023

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga ADS/hibrid.info. Të drejtat e pronës intelektuale mbrohen me Ligjin Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta dhe me Ligjin Nr. 05/L-047 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta.

Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme elektronike apo të bartet, në çfarëdo forme apo me çfarëdo mjeti, qoftë mekanik, me fotokopje, incizim apo në mënyra të tjera, pa lejen paraprake me shkrim të botuesit

Ky raport është publikuar nga Action for Democratic Society (ADS) në kuadër të projektit “Promovimi i gazetarisë objektive dhe lufta kundër dezinformimit”, që mbështetet nga National Endowment for Democracy (NED).

Përmbajtja e dokumentit është përgjegjësi e ADS-së dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyron qëndrimin e NED-it.

Projekti financohet nga:



Projekti realizohet nga:



Përmbajtja

Kategoritë vlerësuese të keqinformimit

Temat e përdorura për krijimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese

Llojet e fushave tematike

Llojet e publikuesve

Klasifikimi i publikimeve të mediave në gjuhën shqipe dhe serbe

Llojet e mediave sociale

Figurat dhe Institucionet më të përfolura

01. 02. 03. 04. 05. 06. 07.

Hyrje

Ky raport përmbledhës dhe përshkrues, i pari i këtij lloji në Kosovë deri më tash, pasqyron gjendjen e informimit (keqinformimit) gjatë muajit qershor 2023, bazuar në të dhënat e siguruara nga platforma për kontroll të fakteve – hibrid.info. Format i këtij raporti është monitorues dhe paraqet gjendjen për një periudhë njëmuajore, ndërsa ky është raporti i dymbëdhjetë mujor i publikuar deri më tash.

Ky raport është i ideuar nga platforma për kontroll të fakteve hibrid.info, pjesë e OJQ-së kosovare “Action for Democratic Society” (ADS) dhe mbështetet nga fondacioni amerikan “National Endowment for Democracy” (NED) në kuadër të projektit “Promovimi i Gazetarisë Objektive dhe Luftimit të Dezinformatës”.

Në kuadër të raportit jepet një pasqyrë për formën e informimit mediatik me ngjarjet për dhe rreth Kosovës. Në vazhden e këtij raporti paraqiten disa figura (grafika) të dala nga baza e të dhënave të hibrid.info e ndarë përmes disa kategorive të vlerësimit që janë pjesë e metodologjisë për kontroll të fakteve të kësaj platforme.

Raporti trajton 8 kategori krahasuese të të dhënave, duke synuar të jep një sqarim më objektiv të gjendjes së informimit dhe për të shpjeguar tendencat e keqinformimit për këtë periudhë monitoruese.

Kategoritë monitoruese janë:


- Vlerësimet e artikujve keqinformues
- Temat e përdorura për krijimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese
- Fushat mbi të cilat janë krijuar dhe shpërndarë artikujt keqinformues
- Institucionet dhe personat e përfolur në artikujt keqinformues
- Llojet e mediave që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese
- Kategorizimi i mediave në gjuhën shqipe dhe serbe që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese
- Llojet e mediave sociale që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese
- Llojet e publikuesve në mediat sociale që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese

Përmbajtja e trajtuar nga hulumtuesit e hibrid.info e që ka shërbyer për ndërtimin e këtij raporti është kryesisht ajo e publikuar në gjuhën shqipe dhe serbe.

Kategoritë vlerësuese të keqinformimit

KATEGORITË KRYESORE


Këtu janë renditur kategoritë kryesore sipas kategorive vlerësuese



Të dhënat e muajit qershor 2023 për gjendjen e keqinformimit në Kosovë tregojnë për ndryshime të dukshme sa i përket trendëve të përmbajtjeve keqinformuese të publikuara nga media dhe publikues të ndryshëm.

Përderisa gjatë muajve të fundit shumica e artikujve keqinformuese ishin kryesisht clickbait dhe dezinformata në disa raste, gjatë këtij muaji lajmet e rreme janë në vendin e parë me 24%, duke dominuar mbi të gjitha kategoritë tjera. Lajmet e rreme pasohen nga dezinformatat me 19%, përmbajtje e paverifikuar me 15% dhe clickbait është tek në vendin e katërt me 11%. Kategoria clickbait për herë të parë shënon rënie të konsiderueshme prej kur platforma për kontroll të fakteve, hibrid.info, ka nisur monitorimin e gjendjes së keqinformimit në Kosovë, në muajin korrik të vitit 2022.

Ndër arsyet kryesore të këtyre ndryshimeve në kategoritë e keqinformimit janë rritja e numrit të përmbajtjeve keqinformuese në fushën politike dhe të sigurisë në këtë muaj, të cilat kanë rritur përqindjen e kategorive të lajmeve të rreme dhe dezinformatave. Si rrjedhojë, kjo ka ndikuar në përqindje më të ulët të artikujve clickbait për shkak të numrit dukshëm më të vogël të publikimeve keqinformuese në fushën sociale dhe kronikën e zezë gjatë muajit qershor 2023 që zakonisht marrin vlerësime clickbait.



24% e artikujve keqinformues kanë marrë vlerësimin “Lajm i rremë”.

Analizë e llojeve të vlerësimeve

1

1.1

01. Lajm i rremë

Pothuajse të gjitha lajmet e rreme janë publikuar në gjuhën shqipe nga publikues të ndryshëm në mediat sociale, shumica prej tyre nga llogari që operojnë në TikTok dhe pjesa tjetër nga faqe dhe profile në Facebook. Shumica dërmuese ose rreth 80% e lajmeve të rreme janë krijuar e shpërndarë në fushën politike dhe të sigurisë, si dhe pjesa tjetër për shëndetësi dhe çështje sociale, por në numër shumë më të vogël (rreth 20% të dyja së bashku). Për më tepër, në këto publikime keqinformuese kanë mbizotëruar artikujt për veriun e Kosovës si pasojë e tensioneve dhe protestave të dhunshme nga serbët në komunat veriore të Kosovës kundër kryetarëve të zgjedhur në këto komuna, si dhe kërkesave të vazhdueshme të bashkësisë ndërkombëtare drejtuar Qeverisë së Kosovës për qetësimin e situatës në veri.

03. Përmbajtje e paverifikuar

Edhe në këtë kategori vlerësuese, përmbajtjet keqinformuese më së shumti janë shpërndarë në fushën e sigurisë dhe politikës për veriun e Kosovës, rrëmbimin e policëve të Kosovës nga forcat serbe në territorin e Kosovës, komunitetin serb, raportet Kosovës-SHBA etj. Publikime tjera si përmbajtje e paverifikuar janë shpërndarë edhe për kronikën e zezë dhe sportin, por shumë më pak në krahasim me sigurinë dhe politikën. Shumica e përmbajtjeve të paverifikuara janë publikuar nga mediat dhe publikuesit në gjuhën shqipe

05. Mashtrim

Të gjitha publikimet keqinformuese të vlerësuara si mashtrim janë krijuar dhe shpërndarë nga publikues në mediat sociale. Shumica prej tyre janë publikuar në gjuhën shqipe, nga faqe të ndryshme në Facebook, për çështje sociale dhe politike. Në këtë kategori të keqinformimit është publikuar edhe një artikull në gjuhën angleze, nga një publikues në Reddit, në fushën e kulturës.

02. Dezinformatë

Mediat në gjuhën serbe kanë publikuar më së shumti dezinformata gjatë këtij muaji në fushën politike dhe të sigurisë, të cilat ndërlidhen kryesisht me zhvillimet në veri të Kosovës. Publikimet keqinformuese të këtyre mediave përmbajnë dezinformata sa i përket komunitetit serb në Kosovë, veriut të Kosovës dhe raporteve mes Kosovës e Serbisë. Kurse, publikuesit në gjuhën shqipe kanë shpërndarë dukshëm më pak dezinformata në krahasim me mediat në gjuhën serbe dhe ato përmbajtje lidhen me temën e dialogut Kosovë-Serbi dhe pretendime për sanksione të mundshme ndaj institucioneve të Kosovës si pasojë e situatës në veri të Kosovës.

04. Clickbait

Artikujt keqinformues në kategorinë clickbait janë publikuar kryesisht nga mediat reale në gjuhën shqipe. Edhe këtu kanë mbizotëruar publikimet në fushën politike dhe të sigurisë lidhur me zhvillimet në këto dy tematika në Kosovë për veriun, paralajmërimet për sanksione të bashkësisë ndërkombëtare ndaj institucioneve kosovare, pagat e policëve etj. Në krahasim me periudhat paraprake monitoruese, në muajit qershor 2023 ka pasur jashtëzakonisht më pak keqinformime në fushën sociale që kanë marrë vlerësime clickbait (vetëm dy artikuj gjithsej). Karakteristikë tjetër është se këtë muaj nuk ka artikuj clickbait në kuadër të kronikës së zezë, të cilat kishin dominuar ndjeshëm në muajt para qershorit.

06. Gabim

Një numër i vogël i artikujve keqinformues janë shoqëruar me gabime në përmbajtjet e tyre. Edhe në këtë kategori shumica prej tyre janë në fushën politike të publikuara nga media reale në gjuhën shqipe që trajtojnë temën e veriut dhe rolin e SHBA-së në Ballkanin Perëndimor, si dhe një publikim për kronikën e zezë për tërmet në Shqipëri.


Artikuj të tjerë me përmbajtje keqinformuese janë vlerësuar në kategoritë “Teori konspirative”, “Manipulim i fakteve”, “Pseudoshkencë” dhe nga kombinimi i kategorive keqinformuese “Përmbajtje e paverifikuar / Gabim”, “Pseudoshkencë / Përmbajtje e paverifikuar” dhe “Raportim i njëanshëm / Përmbajtje e paverifikuar”.

Temat e përdorura për krijimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese

2

KATEGORITË KRYESORE

Këtu janë renditur kategoritë kryesore sipas temave




Tema e veriut të Kosovës ka mbizotëruar pashmangshëm mbi temat tjera gjatë muajit qershor 2023, ngjashëm si në muajin paraprak (maj 2023), por këtë herë me përqindje dukshëm më të lartë. Rreth 27% e të gjitha publikimeve këtë muaj kanë trajtuar zhvillimet në veri dhe komunat veriore kundrejt 12% të përmbajtjeve keqinformuese për të njëjtën temë në muajin maj 2023 dhe me këtë vërehet se ka rritje të konsiderueshme të keqinformimeve për veriun prej 15% në muajin qershor 2023.

Rritja e publikimeve keqinformuese për veriun nga media dhe publikues të ndryshëm përputhet me dinamikën e zhvillimeve dhe ngjarjeve politike dhe të sigurisë në veriun e Kosovës gjatë këtij muaji që pas mbajtjes së zgjedhjeve për kryetarë të komunave në komunat veriore të vendit në muajin prill 2023. Përcjellja e kryetarëve të rinj të komunave veriore në objektet e komunave nga njësitë speciale të Policisë së Kosovës, si dhe protestat e tensionet e dhunshme në veri të nxitura nga Serbia dhe grupe kriminale të udhëhequra nga Beogradi kundër Policisë së Kosovës, KFOR-it, EULEX-it dhe ekipeve të mediave kosovare, por edhe zhvillime tjera për dhe rreth veriut kanë karakterizuar zhvillimet politike gjatë muajit qershor 2023. Kjo në mënyrë të paevitueshme ka ndikuar që fokusi i mediave dhe publikuesve të jetë i orientuar në raportimin lidhur me ngjarjet në veri, përfshirë këtu edhe artikuj me përmbajtje keqinformuese këtë muaj.

Publikimet keqinformuese për veriun janë krijuar dhe shpërndarë më së shumti nga media dhe publikues që operojnë në gjuhën shqipe, gjegjësisht 65% e publikimeve për veriun janë shpërndarë në gjuhën shqipe. Prej publikuesve në gjuhën shqipe, për veriun më së shumti kanë publikuar faqe dhe llogari të ndryshme në media sociale (me theks të veçantë dominon TikTok dhe më pak Facebook), por dukshëm më pak mediat reale dhe portalet e dyshimta. Pjesa tjetër e përmbajtjeve keqinformuese për veriun ose 29% e tyre janë publikuar nga mediat në gjuhën serbe dhe rreth 6% nga publikues në gjuhë të tjera. Megjithatë, nëse merren për bazë krahasimi vetëm mediat reale, atëherë vërehet se mediat reale në gjuhën serbe (63%) kanë krijuar e shpërndarë më shumë keqinformime për veriun se sa mediat reale në gjuhën shqipe (38%).

Publikuesit dhe mediat në gjuhën shqipe, në raportimet e tyre keqinformuese për veriun, kanë publikuar pretendime se CIA paralajmëron konflikt të armatosur në Kosovë, se do të nis luftë e re në vend, se në muajin korrik 2023 do të nis luftë për shkak të grupit mercenar rus Wagner, për prani të grupeve kriminale ruse në veri etj. Ndërsa, mediat në gjuhën serbe kanë shpërndarë përmbajtje keqinformuese duke pretenduar pa fakte se Policia e Kosovës ka hedhur gaz lotsjellës mbi fëmijët në veri të Mitrovicës, se kryeministri Kurti po bën kontrabandë armë nga Ukrainë te armiqtë e SHBA-së, si dhe duke i ndërlidhur tensionet në veri se kanë për qëllim ndarjen e Vojvodinës nga Serbia etj.

Edhe temat tjera të cilat kanë mbizotëruar në këtë periudhë njëmuajore ndërlidhen në një mënyrë apo tjetër me çështjen e veriut, siç janë artikujt keqinformues për komunitetin serb dhe marrëdhëniet mes Kosovës e Serbisë. Ndërsa, temat në fushën sociale kanë pësuar rënie të dukshme këtë muaj, ku kanë qarkulluar disa keqinformime në formën e mashtrimeve për dhënie të kredive etj.



52% e temave kryesore janë për veriun e Kosovës, komunitetin serb, raportet Kosovë-Serbi, dhënie të kredive, sanksionet, rolin rus në Ballkan etj.

Analizë e kontrolleve të fakteve sipas temave

2.1

Zhvillimet e shumta në veriun e Kosovës kanë mbizotëruar mbi çfarëdo teme tjetër këtë muaj. Në vijim analizohen, në formë të përmbledhur, katër temat kryesore të trajtuara nga media dhe publikues të ndryshëm, sipas matjeve të platformës hibrid.info përmes metodologjisë së kontrollit të fakteve.

01. Veriu

Pjesa më e madhe e publikimeve keqinformuese për veriun këtë muaj ose 76% e tyre janë publikuar në kuadër të fushës së sigurisë dhe rreth 24% në fushën politike. Shumica prej tyre janë vlerësuar në këto kategori të keqinformimit: lajm i rremë, dezinformata dhe përmbajtje e paverifikuar. Mediat dhe publikuesit në gjuhën shqipe kanë publikuar kryesisht lajme të rreme dhe përmbajtje të paverifikuar për veriun, ndërsa mediat në gjuhën serbe, për sa i përket veriut, kanë krijuar e shpërndarë më së shumti dezinformata dhe një pjesë tjetër teori konspirative. Po ashtu, mediat dhe publikuesit në gjuhën shqipe kanë publikuar më shumë artikuj keqinformues për ngjarjet në veriun e Kosovës në krahasim me mediat në gjuhën serbe. Gjatë këtij muaji vërehet se kishte shumë pak artikuj clickbait për veriun e Kosovës (vetëm një artikull keqinformues për veriun, i publikuar nga një portal i dyshimtë në gjuhën shqipe, u vlerësua si clickbait).

03. Raportet Kosovë-Serbi

Për këtë temë janë shpërndarë manipulime të fakteve, lajme të rreme, dezinformata dhe clickbait nga publikuesit në gjuhën shqipe dhe mediat në gjuhën serbe. Në kuadër të këtyre artikujve keqinformues trajtohet tema e rrëmbimit të policëve kosovarë nga forcat serbe në territorin e Kosovës dhe tema tjera të marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë.

02. Komuniteti serb

Të gjithë artikuj keqinformues lidhur me komunitetin serb në Kosovë janë publikuar dhe shpërndarë nga mediat në gjuhën serbe, në kategoritë e dezinformatës, përmbajtjes së paverifikuar dhe manipulimit të fakteve. Në këto përmbajtje keqinformuese pretendohet pa bazë se institucionet kosovare kanë lista për arrestime brutale të serbëve për ditën e Vidovdanit në Gazimestan, se Kurti ka kërcënuar serbët me dëbim nga Kosova ose burgim të tyre, shtrembërime se Policia e Kosovës ka tentuar t'i shkel protestuesit serbë në Zveçan etj. Edhe këto keqinformime janë në fushën e sigurisë dhe politikës.

04. Dhënie e kredive


Faqe të dyshimta në Facebook, në gjuhën shqipe, kanë publikuar disa keqinformime të vlerësuara si mashtrime për dhënie të kredive. Përmes këtyre përmbajtjeve keqinformuese, këto faqe pretendojnë në mënyrë të rreme se ofrojnë shuma të kredive deri në qindra mijëra euro.

Llojet e fushave

Sipas matjeve për muajin qershor 2023, media dhe publikues të ndryshëm në gjuhën shqipe, si dhe media reale në gjuhën serbe kanë prodhuar dhe shpërndarë më së shumti përmbajtje keqinformuese në fushën politike si pasojë e dominimit të temave lidhur me veriun e Kosovës, raportet Kosovë-Serbi, komunitetin serb dhe temave tjera politike. Gjetje kryesore e këtij raporti mujor është se nga fillimi i monitorimit të gjendjes së keqinformimit në Kosovë nga platforma hibrid.info në korrik të vitit 2022, kjo është hera e parë që publikimet në sferën politike dhe të sigurisë dalin të parat mbi çdo fushë ose temë tjetër të keqinformimit.

FUSHAT KRYESORE

Këtu janë renditur 6-të fushat kryesore



Artikujt keqinformues në fushën politike, në krahasim me muajin paraprak (maj 2023), kanë shënuar rritje prej 11% (nga 31% muajin e kaluar në 42% këtë muaj). Gjatë dy muajve të fundit vërehet trendi i një rritje të përmbajtjeve keqinformuese që trajtojnë tema politike. Ajo pasohet nga fusha e sigurisë me 29% të numrit të keqinformimeve, e cila ka pasur rritje të konsiderueshme prej 12% në krahasim me muajin paraprak (nga 17% në muajin maj 2023 në 29% gjatë muajit qershor 2023). Nëse llogariten të dyja së bashku, atëherë 71% e të gjithë artikujve keqinformues të publikuar në muajin qershor 2023 janë mbizotëruar nga tematikat politike dhe të sigurisë, e cila dëshmon për dominim në masë të madhe të këtyre dy fushave që në të shumtën e rasteve ndërliken dhe bashkëveprojnë me njëra tjetrën, veçanërisht sa i përket veriut të Kosovës dhe marrëdhënieve komplekse ndërmjet Kosovës e Serbisë.

Në anën tjetër, temat keqinformuese në fushën sociale me 10% dhe të kronikës së zezë me 6% kanë pësuar rënie të dukshme këtë muaj. Në muajin maj 2023, përmbajtjet keqinformuese në fushën sociale ishin 17% (rënie prej 7% këtë muaj) dhe të kronikës së zezë më 17% po ashtu (rënie drastike prej 11% këtë muaj).

Shumica e publikimeve keqinformuese me përmbajtje politike janë krijuar dhe shpërndarë nga mediat reale prej 62%, ndërsa 35% nga publikues në mediat sociale dhe 4% nga portalet e dyshimta. Më shumë se gjysma e keqinformimeve në fushën politike janë dezinformata (27%) dhe lajme të rreme (27%). Shumica dërrmuese e dezinformatave janë publikuar nga mediat në gjuhën serbe për zhvillimet në veri të Kosovës, komunitetin serb dhe marrëdhëniet Kosovë-Serbi. Ndërsa, lajmet e rreme janë shpërndarë nga publikues në gjuhën shqipe, në mediat sociale, për tema të ndryshme politike, si veriu, marrëdhëniet Kosovë-Serbi, raportet Kurti-Rama, Rama-Vuçiq etj. Megjithatë, në përgjithësi, artikujt keqinformues më tematikë politike në masën më të madhe janë publikuar nga media dhe publikues në gjuhën shqipe (61%) dhe pjesa tjetër nga mediat në gjuhën serbe (35%) dhe gjuhë të tjera (4%).

Përmbajtjet keqinformuese që kanë trajtuar temat e sigurisë më së shumti janë vlerësuar si lajme të rreme (28%), përmbajtje e paverifikuar (28%) dhe dezinformata (22%). Media dhe publikues në gjuhën shqipe kanë publikuar kryesisht lajme të rreme dhe përmbajtje të paverifikuar në fushën e sigurisë, në të cilat përfshihen raportime keqinformuese për veriun e Kosovës dhe rrëmbimin e policëve kosovarë nga forcat serbe në territorin e Kosovës. Për dallim prej këtyre dy kategorive, të gjitha dezinformatat në sferën e sigurisë janë krijuar dhe shpërndarë nga mediat në gjuhën serbe për veriun dhe komunitetin serb në Kosovë. Edhe në fushën sigurisë, shumica e publikimeve keqinformuese janë shpërndarë nga media dhe publikues të ndryshëm në gjuhën shqipe (61%), të cilat pasohen nga media në gjuhën serbe (33%) dhe në gjuhë të tjera (6%).

Nga ana tjetër, sa i përket artikujve keqinformues për kronikën e zezë dhe çështjet sociale, të gjitha prej tyre janë publikuar nga media dhe publikues në gjuhën shqipe për tema të ndryshme, si dhënie të kredive, aksidente, vrasje etj., të cilat më së shumti janë vlerësuar si mashtrime dhe clickbait.



92% e përmbajtjeve keqinformuese janë për politikën, sigurinë, çështjet sociale, kronikën e zezë dhe shëndetësinë.


4

Llojet e publikuesve

Edhe gjatë muajit qershor 2023 ka vazhduar trendi i muajve paraprakë monitorues që tregojnë se mediat reale kanë publikuar më së shumti përmbajtje keqinformuese lidhur me ngjarje dhe zhvillime të ndryshme rreth Kosovës. Sipas matjeve të këtij muaji, 58% e artikujve keqinformues janë krijuar e shpërndarë nga mediat reale, 36% nga publikues të ndryshëm në mediat sociale dhe vetëm 6% nga portale të dyshimta.

Në krahasim me muajin paraprak (maj 2023), vërehet se këtë muaj ka pasur rritje prej 8% të artikujve që janë publikuar nga mediat reale (nga 50% në muajin maj 2023 në 58% gjatë muajit qershor 2023).

DALLIMI NË PËRQINDJE NË MES
TË PUBLIKUESVE ME
PËRMBAJTJE KEQINFORMUESE




94% e artikujve me përmbajtje keqinformuese janë publikuar nga mediat reale (58%) dhe publikuesit në mediat sociale (36%).

5

Klasifikimi i publikimeve të mediave në gjuhën shqipe dhe serbe

Kjo matje tregon se në cilën gjuhë janë publikuar artikujt keqinformues të monitoruar gjatë periudhës njëmuajore, duke i kategorizuar mediat në gjuhën shqipe, serbe dhe gjuhë të tjera në raport me raportimet e tyre për dhe rreth zhvillimeve në Kosovë.

PËRQINDJA E PUBLIKIMEVE TË MEDIAVE NË GJUHËN SHQIPE DHE SERBE



Edhe këtë muaj mediat dhe publikuesit në gjuhën shqipe kanë publikuar dhe shpërndarë më së shumti përmbajtje keqinformuese prej 71% gjithsej. Ato pasohen nga mediat në gjuhën serbe që kanë publikuar 24% të përmbajtjeve keqinformuese këtë muaj, si dhe 5% në gjuhën angleze.

Trendi i muajit paraprak (maj 2023) ka vazhduar edhe këtë muaj ku vërehet se ka lëvizje sa i përket publikimeve në gjuhën shqipe dhe serbe. Matjet nga monitorimi tregojnë se ka rënie të përqindjes së publikimeve në gjuhën shqipe (rënie prej 5%) dhe rritje e atyre në gjuhën serbe (rritje prej 3%).

Analiza e artikujve të kësaj kategorie

5.1

Në këtë seksion të raportit analizohen publikimet keqinformuese të publikuara nga mediat në gjuhën shqipe, serbe dhe gjuhët tjera. Në vijim është përshkrimi i ndërlidhjes së tyre mes kategorizimeve, fushave dhe temave të trajtuara.

01. Publikimet e mediave në gjuhën shqipe

Mediat reale në gjuhën shqipe kanë publikuar më së shumti përmbajtje keqinformuese në muajin qershor 2023, të cilat pasohen nga publikuesit në mediat sociale dhe pjesa tjetër më e vogël nga portalet e dyshimta. Për dallim prej muajve të kaluar, kur në gjuhën shqipe kishin dominuar keqinformimet në kategorinë clickbait, këtë muaj ka pasur më së shumti lajme të rreme. Kjo për shkak të ngjarjeve të shumta politike dhe të sigurisë në Kosovë lidhur me veriun me theks të veçantë, të cilave u kanë kushtuar rëndësi mediat dhe publikuesit në gjuhën shqipe. Në vendin e dytë dhe të tretë janë artikujt keqinformues me përmbajtje të paverifikuar dhe clickbait, ndërsa dezinformata kishte shumë pak në krahasim me këto kategori të keqinformimit. Politika ka qenë tema kryesore e keqinformimit që është trajtuar nga publikuesit dhe mediat në gjuhën shqipe, e cila pasohet nga siguria në vendin e dytë, ndërsa çështjet sociale dhe kronika e zezë kanë pësuar rënie të dukshme këtë muaj.

03. Publikimet e mediave në gjuhë të tjera

Gjatë kësaj periudhë mujore, dy artikuj keqinformues të publikuar nga llogari në mediat sociale janë në gjuhën angleze. Njëri është nga presidentja Vjosa Osmani, e cila në një postim në Twitter lajmëronte që do t'i adresojë Parlamentit Evropian, megjithatë në postim ajo e kishte vendosur gabimisht fotografinë e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës në vend të asaj të Parlamentit Evropian. Artikulli tjetër në gjuhën angleze u publikua nga një llogari në Reddit, e cila duke përdorur inteligjencën artificiale kishte krijuar dubluesit e aktorit Tom Cruise. Ky artikull keqinformues është vlerësuar si mashtrim.

02. Publikimet e mediave në gjuhën serbe


Të gjitha përmbajtjet keqinformuese të mediave në gjuhën serbe janë tema politike dhe të sigurisë në lidhje me ngjarjet në Kosovë gjatë muajit qershor 2023. Shumica e këtyre publikimeve keqinformuese janë dezinformata, ndërsa në përqindje më të ulët janë artikujt të vlerësuar si manipulim i fakteve, teori konspirative, përmbajtje e paverifikuar dhe lajm i rremë. Dezinformatat e mediave në gjuhën serbe kryesisht ndërlidhen me temën e veriut të Kosovës dhe komunitetin serb në Kosovë, në të cilat janë shpërndarë pretendime të pavërteta sa i përket tensioneve në veriun e Kosovës gjatë këtij muaji sidomos ndaj veprimeve të Policisë së Kosovës në komunat veriore të Kosovës lidhur me sundimin e ligjit dhe duke ngritur pretendime të pasakta ndaj kryeministrit Kurti.

Llojet e mediave sociale

Në këtë seksion analizohen vetëm artikujt keqinformues të publikuar dhe shpërndarë në mediat sociale dhe në këtë rast nuk përfshihen publikimet në mediat tjera (mediat reale dhe portalet e dyshimta).

Edhe këtë muaj ka vazhduar të ketë rënie të publikimeve keqinformuese në Facebook dhe rritje e dukshme e publikimeve në TikTok. Për më tepër, TikTok për herë të parë ka tejkaluar median sociale Facebook, duke u renditur në vendin e parë dhe Facebook në vendin e dytë rrjedhimisht. Në këtë mënyrë, 45% e përmbajtjeve keqinformuese të shpërndara nga publikuesit në mediat sociale janë shpërndarë në TikTok dhe 41% në Facebook, të cilat pasohen në përqindje më të vogla në Twitter (5%), Reddit (5%) dhe Telegram (4%).

PËRQINDJA E PUBLIKIMEVE NË MEDIAT SOCIALE




Llojet e publikuesve në mediat sociale

6.1

Kjo matje analizon, përmes të dhënave monitoruese, ndërveprimin në mediat sociale sa i përket publikimit dhe shpërndarjes së artikujve keqinformues nga publikues të ndryshëm të mediave sociale. Kjo bëhet përmes këtyre kategorive kryesore të publikuesve: llogarive, faqeve dhe profileve që menaxhohen nga përdorues të mediave sociale.

Gjatë këtij muaji, llogaritë në TikTok (45%) kanë publikuar më së shumti përmbajtje keqinformuese lidhur me zhvillimet në Kosovë sa i përket mediave sociale. Ndërsa, faqet (36%) dhe profilet (5%) në Facebook për herë të parë janë renditur në vendin e dytë sa i përket përqindjes së publikimeve keqinformuese në raport me ngjarjet në Kosovë

PËRQINDJA E PUBLIKIMEVE NË MEDIAT SOCIALE



Në vijim analizohen këto kategori të mediave sociale në ndërlidhje me publikimet dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese.

01. TikTok

Shumica dërmuese e publikimeve keqinformuese të llogarive në TikTok ndërlidhen me tema politike dhe të sigurisë për veriun e Kosovës, si dhe disa keqinformime në fushën e shëndetësisë. Të gjitha përmbajtjet keqinformuese të llogarive në TikTok janë lajme të rreme të publikuara në gjuhën shqipe. Përmes tyre pretendohet në mënyrë të rreme për fillimin e një lufte në Kosovë, paraqiten imazhe të ushtarëve të Ukrainës me pretendimin se janë mercenarë të grupit “Wagner” në Mitrovicë, si dhe pretendime tjera të pavërteta që kontekst kryesor kanë zhvillimet në veri të Kosovës gjatë këtij muaji.

02. Facebook


Faqet në Facebook kanë publikuar artikuj keqinformues kryesisht me tematikë politike, por një pjesë e tyre janë edhe për çështje sociale dhe sigurinë. Shtrebrërimet e këtyre publikuesve në Facebook, në fushën politike, ndërlidhen me veriun e Kosovës, ndërsa keqinformimet me përmbajtje sociale janë për dhënie të kredive. Pothuajse të gjitha publikimet e publikuesve në Facebook janë në gjuhën shqipe, me përjashtim të një artikulli nga një profil, i cili është publikuar në gjuhën serbe, lidhur me pretendimin se Rusia është e gatshme të dërgojë tanke në Kosovë nëse Serbia kërkon një gjë të tillë.

03. Twitter, Reddit dhe Telegram

Publikimet në mediat tjera sociale janë dukshëm në përqindje më të vogël në krahasim me TikTok dhe Facebook. Publikuesit në Twitter, Reddit dhe Telegram kanë publikuar përmbajtje keqinformuese në tema të ndryshme, si veriu i Kosovës, një gabim në postimin e presidentes Osmani që kishte ngatërruar Parlamentin Evropian me Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës dhe një mashtrim i bërë përmes inteligjencës artificiale për aktorin Tom Cruise. Përmbajtjet keqinformuese të publikuesve në këto media sociale janë në gjuhën angleze dhe gjuhë të tjera.

Figurat dhe institucionet më të përfolura


Kjo matje analizon të dhënat se cilat kanë qenë institucionet dhe personalitetet (figura publike e politike) më të përfolura përmes monitorimit të artikujve me përmbajtje keqinformuese.



Policia e Kosovës ka rezultuar si institucioni më i përfolur nga publikimet keqinformuese gjatë muajit qershor 2023. Kjo është e pritshme marrë parasysh zhvillimet në veriun e Kosovës gjatë këtij muaji, gjegjësisht përfshirjen e Policisë në aksionet e sundimit të ligjit në veri të vendit dhe vendosjen e njësive speciale policore në komunat veriore të Kosovës pas betimit të kryetarëve të rinj të këtyre komunave, si dhe tensioneve të shkaktuara nga protestat e dhunshme të serbëve në këto komuna. Media dhe publikues në gjuhën shqipe dhe serbe kanë përfolur Policinë lidhur me veriun, komunitetin serb, rrëmbimin e policëve kosovarë në territorin e Kosovës nga ana e forcave serbe dhe pagat e policëve.

Institucione ose organizata tjera të përfolura janë grupi "Wagner", CIA dhe seriali komik "The Simpsons".

RENDITJA E PERSONAVE MË TË PËRFOLUR SIPAS PËRQINDJES



Sipas të dhënave të monitorimit, edhe gjatë këtij muaji, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, është personaliteti më i përfolur nga përmbajtjet keqinformuese në kontekst me personalitete tjera, siç prezantohet në figurën përkatëse dhe atë kryesisht për zhvillime politike në raport me veriun e Kosovës. Publikuesit dhe mediat në gjuhën shqipe kanë krijuar shpërndarë pretendime të pavërteta se Kurti nuk do të jetë më në bisedime Kosovë-Serbi dhe do të zëvendësohet nga presidentja Osmani, për ultimatumet të emisarit amerikan, Escobar ndaj Kurtit për tërheqje të Policisë së Kosovës nga objektet e komunave veriore, si dhe pretendime se Kurti ka deklaruar që kryeministri shqiptar, Rama, mban anën e Serbisë ndaj Kosovës. Ndërsa, mediat në gjuhën serbe kanë dezinformuar se Kurti ka kërcënuar serbët më dëbim nga Kosova ose burgim të tyre, se është i gatshëm të rrëzojë presidentin serb Vuçiq etj.

Personalitete tjera të përfolura janë zyrtarja e Ministrisë së Jashtme ruse, Maria Zakharova, kryeministri shqiptar e presidenti serb Rama / Vuçiq etj.

Metodologjia

Për hartimin e këtij raporti monitorues janë përdorur metodat kuantitative dhe ato kualitative.

Sa i përket metodave kuantitative, fillimisht është krijuar baza e të dhënave nga ADS/hibrid.info me qëllim të zbërthimit dhe analizimit të detajuar të trendëve të keqinformimit. Përmes kësaj baze të të dhënave, e cila mirëmbahet dhe përditësohet në bazë të rregullta ditore nga stafi i ADS/hibrid.info, monitorohen rregullisht artikujt me përmbajtje keqinformuese.

Kjo nënkupton se të gjitha artikujt e publikuar në platformën hibrid.info vendosen në bazën e të dhënave dhe kjo e fundit shërben ndër burimet kryesore për përgatitjen e raportit monitorues. Për më tepër, metodologjia e përdorur për analizimin e të dhënave të paraqitura në raportin monitorues bën të mundur filtrimin e të dhënave në baza ditore, javore e mujore dhe atë në formë kryesisht kuantitative për të kuptuar më qartë fenomenin e keqinformimit të atyre artikujve të analizuar për këtë periudhë monitoruese njëmuajore sipas kategorive e vlerësimeve të ndryshme.

Krahas kësaj, një burim tjetër i rëndësishëm për këtë raport është metodologjia e ADS/hibrid.info (e publikuar në faqen e hibrid.info) për luftën kundër dezinformatës dhe lajmeve të rreme. Metodologjia, e cila është e bazuar para së gjithash në metodat kualitative, është hartuar nga stafi profesional i ADS/hibrid.info dhe është në harmoni me standardet më të larta ndërkombëtare për kontroll të fakteve, gjegjësisht sipas udhëzimeve të Rrjetit Ndërkombëtar për Kontroll të Fakteve (IFCN). ADS/hibrid.info është anëtarë me të drejta të plota në këtë mekanizëm ndërkombëtar – IFCN.

Ky raport monitorues përfshin periudhën nga 1 deri më 30 qershor 2023.

Ky raport i shkurtër monitorues paraqet një pasqyrë të gjendjes njëmuajore të informimit (keqinformimit) gjatë muajit qershor 2023, nga të dhënat e platformës për kontroll të fakteve – hibrid.info.

Gjatë këtij muaji, mediat dhe publikuesit kanë krijuar dhe shpërndarë më së shumti lajme të rreme prej 24% që kanë mbizotëruar mbi kategoritë tjera të keqinformimit. Ato pasohen nga dezinformatat me 19%, përmbajtjet e paverifikuara me 15%, ndërsa clickbait kanë rënë në vendin e katërt me 11%. “Lajmet e rreme” janë publikuar kryesisht në fushën politike dhe të sigurisë nga publikues në mediat sociale, në gjuhën shqipe, lidhur me ngjarjet në veri të Kosovës. Publikimet “Dezinformata” janë shpërndarë më së shumti nga mediat në gjuhën serbe për tema politike dhe të sigurisë në kontekst të zhvillimeve në veriun e vendit. Edhe sa i përket përmbajtjeve keqinformuese në kategorinë “Përmbajtje e paverifikuar”, shumica e artikujve janë në fushën e sigurisë dhe politikës për veriun, rrëmbimin e policëve kosovarë nga forcat serbe në territorin e Kosovës, komunitetin serb etj., si dhe keqinformime për kronikën e zezë dhe sportin. Gjetje tjetër kryesore është se edhe vlerësimet “Clickbait” kanë marrë publikimet keqinformuese në fushën politike dhe të sigurisë për veriun, por edhe disa artikuj me tematikë sociale.

Fokusi kryesor i mediave dhe publikuesve në muajin qershor 2023 është rreth temës së veriut të Kosovës. Si rrjedhojë e ngjarjeve të shumta në veri ka ndikuar që gjatë këtij muaji të ketë më së shumti publikime keqinformuese mbi këtë temë duke lënë mbrapa të gjitha tematikat tjera. Çështje tjera të trajtuara ndërlidhen me veri po ashtu, si komuniteti serb në Kosovë, marrëdhëniet mes Kosovës e Serbisë, paralajmërimet për sanksione të mundshme të bashkësisë ndërkombëtare ndaj Kosovës etj. Ndërsa, vërehet rënie e dukshme e temave sociale dhe të kronikës së zezë për shkak të dominimit medial të temës së veriut. Lidhur me fushat e keqinformimit, politika ka dominuar pashmangshëm në vendin e parë me 42% dhe siguria me 29% në të dytin, të cilat kanë shënuar rritje të madhe këtë muaj në krahasim me muajt paraprakë. Ndërsa, fusha sociale ka rënë në 10% dhe kronika e zezë në 6%.

Edhe këtë muaj, mediat reale kanë dominuar në publikimin e përmbajtjeve keqinformuese lidhur me zhvillimet për dhe rreth Kosovës, ku 58% e të gjitha keqinformimeve janë publikuar nga ky lloj i mediave, 36% nga llogari, faqe dhe profile në mediat sociale, si dhe 6% nga portale të dyshimta. Mediat dhe publikuesit në gjuhën shqipe kanë publikuar më së shumti lajme të rreme në ndërlidhje me veriun e Kosovës, ndërsa politika, si fushë e keqinformimit, është përdorur më së shumti për shpërndarje të përmbajtjeve keqinformuese në gjuhën shqipe. Ndërsa, artikujt keqinformues të mediave në gjuhën serbe janë publikuar në fushën e politikës dhe sigurisë, të cilat kanë shpërndarë kryesisht dezinformata për zhvillimet në veri të Kosovës. Prej publikuesve në mediat sociale, TikTok ka tejkaluar Facebook sa i përket numrit të artikujve keqinformuese duke u renditur e para me 45% të publikimeve dhe Facebook e dyta me 41%, si dhe mediat tjera sociale, si Twitter (5%), Reddit (5%) dhe Telegram (4%) me dukshëm më pak publikime keqinformuese. Shumica dërmuese e tyre janë publikuar në gjuhën shqipe dhe temat kryesore të trajtuara janë çështjet politike dhe të sigurisë në Kosovë.

Institucioni më i përfolur është Policia e Kosovës nga media dhe publikues në gjuhën shqipe e serbe për veriun e Kosovës, komunitetin serb, rrëmbimin e policëve kosovarë në territorin e Kosovës nga ana e forcave serbe dhe pagat e policëve. Sa i përket personaliteteve, kryeministri Albin Kurti ka vazhduar të ketë vëmendjen më të madhe në raportimet keqinformuese edhe këtë muaj kryesisht për zhvillime politike në raport me veriun e Kosovës.

HIBRIDO.INFO